



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:920254

Datë: 28.05.2021

Numri i dokumentit: 01826834

**Ae.nr.287/2019**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Rrustem Thaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit [“A...”], me seli në fshatin ..., Komuna e Podujevës, të cilën me autorizim e përfaqëson [N.P], avokat nga Prishtina, kundër të paditurës “Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, pranë Ministrisë së Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Manushaqe Bytyqi, për kompensim e dëmit për shkak të mos përmbushjes së kontratës, në shumën e përgjithshme prej 19,321.55€, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.383/2018, të datës 28.05.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.05.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit [“A...”], me seli në fshatin ..., Komuna e Podujevës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.383/2018, të datës 28.05.2019, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar në piken I të dispozitivit të aktgjykimit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit [“A...”], me seli në fshatin ..., Komuna e Podujevës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri “Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, pranë Ministrisë së Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me seli në Prishtinë, që në emër të mos përmbushjes së kontratës paditëses t’ia paguaj shumën prej 19,321.55€ me kamate ligjore, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Ndërsa në piken II të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditësi [“A...”], me seli në fshatin ..., Komuna e Podujevës, për shkak të shkeljeve të dispozitave të

procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës material, me propozimin që Gjykata Apelit në Prishtinë, aktgjykimin EK.NR.383/18 i datës 28.05.2019 ta ndryshoje dhe kërkesëpadinë ta aprovoje në tërësi ose ta prishë dhe lëndën ta kthej në rivendosje.

Përgjigje në ankese nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së , gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ["A..."], me seli në fshatin ..., Komuna e Podujevës, me datën 16.07.2018 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurës "Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, pranë Ministrisë së Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me seli në Prishtinë, për shkak të mos përmbushjes së kontratës, i ka propozuar gjykatës që ta aprovohet kërkesëpadija e paditësit dhe të obligohet e paditura që paditësit në emër të vlerës së kontraktuar për përkrahje financiare sipas kontratës nr. ..., ti paguaj diferencën në shumën prej 19,321.55€ me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 24.04.2018 e deri në pagesën definitive si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës të gjitha në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktgjykimit nën kërcënimin e përnbarimit të detyrueshëm.

Gjykata e shkallës së parë së parë pas administrimit të provave ka gjetur se ishte jo kontestuese se pala paditëse është përfituese e projektit investiv të zhvillimit rural dhe se me palën e paditur kanë lidhur edhe kontratë me numër ... për përkrahje në investim ku në bazë të kontratës vlera e investimeve të përgjithshme të pranuar do të jetë në shumën prej 64,735.00€, dhe se pala e paditur me kontratë ka marrë detyrimin që ti ofroje përkrahje publike në shkallën prej 65% të investimeve të pranuar gjegjësisht shumën prej 42,077.75€. Po ashtu ishte jo kontestuese se pala e paditura do të ekzekutonte pagesën tek pala paditëse përfituese vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit investiv dhe pas kontrollit në terren nga pala e paditur në përputhje me Udhëzimet Administrative të palës së paditur, dhe se çdo parregullsi e vërejtur në investim mund të këtë për pasojë jo validitetin e pagesave. Pala paditëse me datën 18.10.2017 palës së paditur i është drejtuar me kërkesë për ndërrimin e lokacionit për ngritjen e depos (frigo) për ruajtjen e frutave dhe pas kontrollit të bërë në terren me datën 01.11.2017 pala e paditur e ka miratuar kërkesën e palës paditëse për ndërrimin e lokacionit për ndërtimin e depos për ruajtjen e frutave. Komisioni i palës së paditur ka dalë në terren për verifikimin e investimeve të bëra dhe ka konstatuar se pala paditëse nuk i është përmbajtur kontratës, ngase në depon e ftohjes se fidanëve nuk gjenden pajisje të ftohjes. Pala paditëse ka parashtruar kërkesën për kompensimin ku edhe ja ka bashkangjitur edhe dokumentacionin përkatës në lidhje me çmimin e investimeve. Pala e paditur ka bërë verifikimin e investimeve të bëra e investimeve të bëra në terren dhe i ka pranuar investimet deri në shumën prej 22,756.20€, ngase ka konstatuar se çmimi i investimeve është i barasvlershëm me këtë shumë, ndërsa kalkulimet e çmimeve të investimeve e ka bërë sipas çmimoreve të saj, po ashtu është bazuar edhe në raportin e komisionit i cili ka bërë verifikimin e investimeve të bëra nga pala paditëse. Ishte jo kontestuese se pala e paditur nuk i ka kompensuar në tërësi shumën prej 42,077.75€ me pretendimin se pala paditëse nuk i është

përmbajtur kontratës, rrjedhimisht nga vlera e përgjithshme e përkrahjes ia ka zbritu shumë prej 19,321.55€ edhe për faktin se edhe pjesën e kompensimit të bërë është bërë sipas çmimit të cilat i posedon e paditura.

Prandaj, gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të mos përmbushjes t'ia paguaj shumë prej 19,321.55€, me arsyetimin se pala paditëse nuk ka arritur që të provojë faktet e pretenduara me padi. Mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 par.1, 245 par.1 të LMD-së, si dhe në dispozitën e nenit 143 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenet 8 par.1 dhe 245 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku me dispozitën e nenit 8.1 të LMD-së parashihet se *“pjesëmarrësit në marrëdhëniet të detyrimeve kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vetë dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”*, ndërsa në dispozitën e nenit 245 par.1 të LMD-së është përcaktuar se *“kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht si kundër është përmbushja e tij”*. kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, pasi që në rastin konkrete paditësi dhe i padituri kanë qenë në raport kontraktuese nga kontrata me numër ... për përkrahje publike ku pala e paditur ka marrë detyrimin e pagesës së shumës prej 42,077.75€ në emër të përkrahjes së investimeve të cilën e ka bërë paditësja, dhe se nga provat e shqyrtuara është konstatuar se e paditura e ka paguar vetëm shumë prej 22,756.20€, ngase nga konstatimi i komisionit të palës së paditur është konstatuar se pala paditëse nuk i është përmbajtur kontratës.

Kjo gjykate vlerëson se me neni 4 të kontratës është përcaktuar se pagesat në lidhje me përkrahjen publike ekzekutohen duke u bazuar në kërkesën e paraqitur nga përfituesit paditësi dhe se autorizimet e pagesës do të behën në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga përfituesi dhe rezultateve të kontrollit. Pastaj çdo autorizimit i pagesës mund të behet jo valid në raste se ndonjë parregullsitë të vërejtur nga komisioni. Në rastin konkret komisioni palës së paditur pas kontrollit të bërë në teren ka dhënë vërejtje në lidhje me ndërtimin e depos me pretendimin së depoja nuk ka ftohje dhe se pala e paditur ka kryer pagesat në bazë të konstatimi të komisionit e duke u bazuar në kontratë. Prandaj, Gjykata Apelit vlerëson së pretendimet e palës së paditëse me provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk ka arritur që të provojë faktet e pretenduara më padinë e parashtruar.

Numri i lëndës: 2020:920254  
Datë: 28.05.2021  
Numri i dokumentit: 01826834

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e palës paditëse lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e paditësit janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërrthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,**  
**Ae.nr.287/2019, dt. 25.05.2021**

**KRYETARI I KOLEGJIT**

**Mahir Tutuli, d.v.**

